



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:163786

Datë: 07.07.2022

Numri i dokumentit: 03210482

P.nr.989/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi dhe bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër të pandehurve M.T nga fshati ...-Mitrovicë dhe P.H nga fshati ...-Mitrovicë, për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par 2 nën par 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.338-9/20 e datës 23.11.2020 pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 31.05.2022 në praninë e Prokurorit të shtetit Zana Sadiku Sertolli, të dëmtuarit Rr.K, si dhe të pandehurve M.T dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Rexhep Kaçaniku dhe P.H dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Isa Hyseni me dt.03.06.2022 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me dt.20.06.2022 përpiloi shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.M.T, nga fshati ..., Komuna Mitrovicë, i lindur me ..., nga i ati H. dhe e ëma Z. e vajzërisë B., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kasap, i papunë, me gjendje të dobët ekonomike, i martuar, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ...

2 P.H nga fshati....., Komuna Mitrovicë, i lindur me ..., nga i ati N.dhe e ëma Sh., e vajzërisë K., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion kasap, i martuar, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal.....,

JANË FAJTOR

Për shkak se,

Me 17 Janar 2018, i akuzuari P.H në fshatin ..., komuna e Vushtrisë në tregun e kafshëve nga persona të panjohur kishte blerë një lopë nga tre persona që nuk i ka njohur në çmim prej 830 euro dhe të njëjtën me qëllim përftimi ia ka shitur blerësit M.T që e njihte edhe me herët në çmim prej 950 euro edhe pse të njëjtit ishin në dijeni se kafsha lopa në fjalë ishte e vjedhur, ngase ishte blerë nga shitës të pa identifikuar dhe pa matrikulla që posedojnë kafshët në këtë rast dhe se si rrjedhojë pas identifikimit që i është bërë nga ana e djalit të pronarit e njëjta i është kthyer të dëmtuarit Rr.K.

- **me të cilin veprim secili veç e veç kanë kryer veprën penale blerja pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitën e lartcekur ndëshkimore dhe nenit 3,11,15,38,43,47,48,73,75, të KPK dhe nenit 322, 365, 453 dhe 463 të KPRK-së, i:

G J Y K O N

- Të pandehurit M.T i cakton **DËNIM ME GJOBË në shumën** prej 500.00 euro (pesëqind euro) e cila do të paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast mos pagese e njëjta di t'i shndërrohet në dënim me burg duke i llogaritur çdo 20€ (njëzetë euro) gjobë një ditë burg, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të pandehurit P.H cakton **DËNIM ME GJOBË PREJ 500.00 euro** (pesëqind euro) e cila do të paguhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , në këste mujore, ndërsa në rast mos pagese e njëjta di t'i shndërrohet në dënim me burg duke i llogaritur çdo 20€ (njëzetë euro) gjobë një ditë burg, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Udhëzohet i dëmtuari Rr.K që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në kontest civil.
- Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej nga 50 € (tridhjetë euro) dhe në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Dhunës shumën

prej 30 € (tridhjetë euro) në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.338-9/20 të dt. 23.11.2020 ka ngarkuar të akuzuarit M.T nga fshati ...Mitrovicë dhe P.Hnga fshati ... -Mitrovicë,për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 327 par 2 nën par 2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, kurse në fjalën përfundimtare të dt. 31.05.2022 në fjalën përfundimtare ka ndërruar kualifikimin juridik të veprës penale në veprë penale të kryer veç e veç blerja pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 1 të KPRK-së, duke propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t'i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 06.07.2021 në të cilën shqyrtim të akuzuarit nuk e pranuan fajësinë dhe pranë këtij qëndrimin kanë mbetur edhe gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor të dt. 07.04.2022

Ngase të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë edhe në shqyrtimet gjyqësor të dt. 07.04.2022, në procedurën e provave gjykata bëri dëgjimin e dëshmitarit – të dëmtuarit Rr.K, dëshmitarëve B.K, dëshmitarin A.H, lexoi provat materiale, raportin e oficerit , vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.17.01.2018 , listën e kafshëve sipas fermave të dëmtuarit Rr.K, si dhe mori në shqyrtim mbrojtjen e të akuzuarave.

I dëmtuari Rr.K, ka deklaruar se ka dhënë deklaratë në polici dhe prokurori dhe mbetet pranë deklaramit të dhënë. Ai merret me kultivimin e bagëtive dhe se në stallën e tij kishte pasur 4 lopë dhe një viç prej të cilave 3 kanë pasur ngjyrë të kuqe dhe bardhë ndërsa njëra me ngjyrë të zezë të cilën ia kanë gjete policia dhe ja kanë kthyer. Të njëjta kanë pasur shenjat e veterinerit(matrikullat) . Në vijim deklaroi se ditën kritike lopët i kishte mbyllur në stallë dh se deri në ora 01 pas mesnate kishin qenë në stallë porse rreth orës 05.00 kur kishte shkuar bashkëshortja e tij për ti shikuar ka vrenjtur se stalla kishte qenë e hapur me forcë dhe janë vrenjtur gjurmët e kafshëve deri në fshatin ... ku ka parë shenja të një mjeti transportues në të cilin ishin ngarkuar kafshët. Pas lajmërimit të rastit në polici pas një muaji e kanë njoftuar se në Mitrovicë është gjetur njëra nga lopët të cilën e kishte identifikuar djali i tij dhe pas që kishin paguar një mjet transportues e kishin sjell në shtëpi.

Dëshmitari B.K ka deklaruar se pas një muaji pasi i janë vjedhur lopët e kanë ftuar policia dhe e kanë ftuar që të shkojnë në Mitrovicë dhe pasi që kanë shkuar në Mitrovicë në një shtallë dhe ka bërë identifikimin e lopës që nuk e kishte pasur problem ngase ka pasur prej se ishte e vogël dhe se e njëjta ka pasur ngjyrë balush në kokë dhe ngjyrë e përhimët në pjesët tjera dhe se pasi kishin marrë lopën me një mjet transportues e kishin sjell në shtëpi. Në vijim deklaroi se lopët kanë pasur shenjat e matrikulimit kurse nuk e dinë se shenjat që janë gjetur në vend ngjarje a janë të lopëve të tija apo jo ngase këtë evidencë e posedon vetëm veterineri A.

Dëshmitari A.H-veteriner ka deklaruar se profesionin e ushtron që 30 vite dhe se të dëmtuarin e njeh dhe nuk i kujtohet kur e ka vizituar herën e fundit por për këtë ekzistojnë regjistrat dhe se i përket matrikualave që janë në shkresat e lëndës i njëjti ka bërë identifikimin e gjedhave dhe pronarët e tyre dhe ka rezultuar se asnjëra prej tyre nuk i përkiste gjedheve që i ka poseduar i dëmtuari Rr.K.

Gjykata gjatë procedurës së marrjes së provave **lexoi:** raportin e oficerit , Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 17.01.2018, lista e kafshëve sipas fermave të dëmtuarit rr.K dhe foto dokumentacioni, si dhe shkresat e tjera të cilat gjenden në lëndë.

I akuzuari M.T në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk e dinë se ku gjendet fshati ... e aq më pak të ketë vjedhur diçka në shtëpinë e tij. Me profesion është kasap dhe se në shtëpinë e tij janë ardh policia e Ferizajt dhe kanë kërkuar leje me hy në stallë ku kanë fotografuar lopët që kanë qenë aty dhe kanë kërkuar që njërin prej tyre mos ta lëvizin prej aty dhe pas një ore është ardhur djali i të dëmtuarit dhe pas identifikimit të lopës të njëjtit më kanë kërkuar të siguroj një mjet transportues dhe pasi kemi gjetur mjetin lopën ia kemi kthyer në shtëpi dhe se deri aty kanë pasur sjellje korrekte, kurse në stacion kanë ushtruar dhunë ndaj tij për çka e ka paraqitur rastin në IPK , kurse pasi ishte kthyer në Mitrovicë tek ai kishte shkuar P. dhe pastaj në Stacionin policor në Mitrovicë ka deklaruar se ma ka shitur mua lopën.

I akuzuari P.H në mbrojtjen e tij deklaroi e kam të qarte për çka akuzohem dhe nuk nevojë për sqarime shtese. Kam dhënë intervistë në procedure paraprake ne polici dhe prokurori dhe qëndroj ne tërësi. Unë me profesion jam kasap dhe pazari i fundit ka qenë ne vitin në fundin e vitit 2017 ne pazarin Vushtrisë , me të gjitha mjetet e mia përcjellse dhe duke kërkuar punë të punoj të gjej dikën me pre-therr dhe jam takuar në Pazar me 3 person të cilat kishin pasur një lope dhe unë kam menduar që donë me therrë por me ofruan të njëjtën për shitje . të njëjtit më kanë thënë se lopa është pak e stresuar dhe pasi që e njëjtat me pëlqej e kam blerë të njëjtën , prej aty më kanë propozuar me e marre lopën dhe unë ju thash nuk kam me çka e qoj të shtëpia dhe të njëjtit ma kanë sjell deri në shtëpi me një kombi të kuq. Unë lopën në fjalë e kam

marr me therrë por unë pas dyshimit tim se ishte pas e fryt , kam marr mjekun e ka këqyr ajo ka dal barsë, dhe pasi që nuk kisha ku ta mbaj pas 2-3 ditëve e kam takuar M. të Lekuart ku shiten dhe kam biseduar me të se e kam një lopë barsë , dhe i cili mban lope dhe jam marr vesh dhe të njëjtit ja kam shit lopën . pastaj M. më erdhi një mbrëmje pas 2 jave erdhe të unë dhe me tha se lopa kishte qenë e vjedhur dhe me tha se nesër me kane caktuar me u paraqit ne Stacioni Policore ne Ferizaj dhe unë kur e kam kuptuar këtë shkova drejt në stacionin policore në Mitrovicë të lajmëroj se do të jem ne stacionin policore në Ferizaj . dhe të nesërmen kam shkuar në stacionin policore ne Ferizaj dhe kam bërë deklarinimin tim. Personat që me kanë ofruar lopën në shitje me kane thënë që janë nga ... Komuna Obiliqit. Unë e kam blerë lopën 830 euro kurse M. ja kam shit 950 euro. Automjeti i transporti ka qenë kombi i kuq me traga 01 diqka tjetër nuk me kujtohet . të dëmtuarin dhe djalin e tij herën e pare i kam takuar vitin e kaluar ne seancën e shqyrtimit gjyqësore këtu në gjykatë. Unë kurrë ne fshatin nuk kam qenë kurrë por edhe në Ferizaj një herë moti kam qenë ne Ferizaj. Unë kurrë asnjëherë nuk e kam vjedhur këtë lope. Dhe nuk e kam pas njohuri se lopa ka qenë e vjedhur dhe po ta dija edhe fal me ma dhanë nuk e kisha marre. Unë gjatë ushtrimit të kasapit nuk kam pas asnjëherë problem me persona .

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të dorëzuar më shkrim ka deklaruar: -

se vlerson fuqishëm dhe bindshëm se me provat e shqyrtuara dhe të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit M.T dhe P.H, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, por nga veprimet e tyre inkriminuese secili veç e veç janë përmbushur elementet e veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 1 të KPRK-së.

Rikualifikimi juridike i veprës penale lidhur me rastin konkret mbështetet në provat personale dhe materiale, ku nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit R.K, është dëshmuar fakti se natë kritike në fsh. ...K. Ferizaj, përkatësisht nga stalla e tij, në mënyrë të kundërligjshme persona të panjohur kishin depërtuar me forcë duke e thyer drynin e derës së stallës, ku nga aty i kanë përvetësuar tre lopë qumështi dhe një mështjerrë, në vlerë mbi 5.500€, me ç’ rast i dëmtuari i kishte pasur në posedim këto gjedhe nga muaji korrik i vitit 2017, e vërtetuar nga lista e kafshëve sipas fermave të lëshuar nga Ambulanta Veterinate “A...” në Ferizaj. Ndërkaq kur është ballafaquar me fotot në shkresat e lëndës ka bërë identifikimin e lopës së tij që është gjetur në stallën e të akuzuarit T.M.

Ndërkaq dëshmitari B.K, e dëshmoi faktin se lopa me balosh në kokë dhe me ngjyrë të përhimët, e gjetur në stallën e të akuzuarit T.M, ka qenë e tyre, mirëpo sa i përket natës kritike nuk ka dëgjuar e as parë ndonjë person duke i vjedhur lopët nga stalla e tyre. Të njëjtit, me datë 18.01.2018, në bazë të Vërtetimit mbi kthimin e sendeve të sekuestruar, i është kthyer një lopë me ngjyrë hiri në të zezë dhe me një shenjë të bardhë në kokë.

Nga dëshmia e dëshmitarit-veterinari A.H duke u bazuar në Sistemin për identifikimin e kafshëve në kuadër të AVUK-ut, u provua se matrikulat me numër RKS ..., ..., ... dhe RKS .. nuk i përkasin gjedhëve, ku pronar është i dëmtuari Rr.K, por ju përkasin pronarëve të tjerë, të cilët nuk janë nga regjioni i Komunës së Ferizaj.

I pandehuri M.T në mbrojtjen e tij, e mohon në tërësi kryerjen e veprës penale, duke shtuar se është e vërtetë se ka i akuzuari P.H kishte blerë një lopë barrsë me ngjyrë hiri, pronë e të dëmtuarit, të cilën e ka blerë në shumë prej 950 euro, dhe sipas mbrojtjes së të pandehurit nuk ka pasur dhe as nuk ka kërkuar dokumentacionin lidhur me lopën e blerë. Pra, mos kërkimi i dokumentacionin veterinar, gjetja e një lope me ngjyrë hiri në të zezë dhe me një shenjë të bardhë në kokë, si dhe pesë copa të matrikulave si në foto dokumentacion, të njëjtat janë sekuestruar përkohësisht në bazë të Vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve, të datës 17.01.2018, në mënyrë të pa kontestueshme vërtetojnë elementin subjektiv dhe objektiv të veprës penale dhe atë se ka blerë një lopë për të cilën e di se është përfituar me kryerjen e veprës penale.

Edhe i pandehuri P.H në mbrojtjen e tij, e mohon në tërësi kryerjen e veprës penale, duke theksuar se në fund të vitit 2017 në tregun e ..., nga tre persona të panjohur kishte blerë një lopë në shumë prej 830 euro, mirëpo e njëjta kishte qenë barrës dhe për këtë arsye ia kishte shitur të akuzuarit T.M, në shumë prej 950 euro. Po ashtu i pandehuri në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 12.05.2022, kishte pranuar se lopa e blerë nga këta persona të panjohur kishte pasur matrikull-vathë, por të njëjtit kur e kanë sjellë në shtëpinë e tij kishte vërejtur se i mungojnë matrikulat, ashtu që një fakti i tillë pa mëdyshje na bind se i pandehuri P.H ka blerë një lopë për të cilën e di se është përfituar me kryerjen e veprës penale.

Prandaj pas vlerësimit të gjithanshëm dhe të drejtë të provave personale dhe materiale, si dhe duke i çmuar dhe ndërlidhur në kontekst logjik dhe faktik me njëra tjetrën, konsideroj se ka prova të mjaftueshme se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 1 të KPRK-së.

Në fund i propozon gjykatës i propozoj që të njëjtit t'i shpallë fajtor dhe t'i dënoj sipas ligjit me një dënim, që do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, ku dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.

Gjykatës i propozon që me rastin e përcaktimit të dënimit si rrethana lehtësuese duhet të merr parasysh sjelljen e akuzuarve pas rastit në fjalë, ndërsa si rrethana rënduese të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe dëmin e shkaktuar kundrejt të dëmtuarit.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare deklaron:- I bashkëngjitem ndjekjes penale si dhe parashtoj kërkesë pasurore juridike te cilën nuk mund ta precizoj .

Mbrojtësi i të pandehurit M.T, av.Rexhep Kaçaniku në fjalën përfundimtare deklaron:- Fjalën përfundimtare ja prezantoj gjykatës ne forme te shkruar për gjykatën dhe prokurori dhe kërkon qe te jete pjese përbërëse e procesverbalit dhe ne vijim do ta elaboroj pikë pamjen time sa i përket ngarkesës se te mbrojturi tim për veprën penale blerja , pranimi ose fshehja e sendeve te përfituar me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par. 1 te KPRK-se. Prokuroria e shtetit deklarohet se “për shkallen e lartë te dashjes dhe mënyrën e kryerjes se veprës penale” pra prokuroria konfirmon se ka dashje te i akuzuari M., por kjo dashje nuk u konfirmua nga askush e posaçërisht nga M. i cili thotë se e njej P. si kasap te ndershëm , ka pasur besim te ai kur e ka blere lopën mbarse dhe pasi qe policia ia ka sekuestruar te njëjtën P. ia ka kthyer 950 €sa ia shiti. Pra me këtë veprim si të mbrojturit tim M. dhe te akuzuarit P. dëshmuar fakti se këta te dy nuk kane pasur dashje, nuk kane ditur se lopa shprehem njëjës e jo lopët si ka qene konstatuar ne aktakuze e tani me nuk e dimë se cili është pretendimi i sendeve te marrura. Dhe kalimthi dua te potencoj faktin se jetoj ne bindje se për këtë vepër penale ka ardhë parashkrimi relativ i ndjekjes për çka ja le gjykatës qe ex officio të vendos.

Ne konsteelacioni e fakteve dhe dëshmimeve te ekzaminuara ne këtë gjykim konsideroj se nuk u dëshmuar se i akuzuari M.T i kreu veprën penale nga neni 345 par.1te KPRK-së andaj me aplikimin e parimit themelore –sentences latine “In dubio po reo” ne mungesë te fakteve e komfor nenit 364 par 1 nen par 1.3 te KPPRK-së i propozoj gjykatës qe M.T ta liroj nga aktakuza e modifikuar sot.

I akuzuari M.T në fjalën përfundimtare deklaron:-E mbështes ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtësit tim dhe nuk kam se far te shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit P.H, av. Isa Hyseni në fjalën përfundimtare deklaron:-se pas administrimit të provave personale dhe materiale nuk u vërtetua se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet konsideroj se prokurori i shtetit sa i përket provave te prezantuar ne shqyrtimin gjyqësor nuk ka ushtruar drejt përgjegjësit dhe autorizimet ligjore qe faktet shfaqësuese ti vlerëson për te mbrojturin tim citojmë nenin 7 par 2 te KPK-se, ku thotë se sipas dispozitave me këtë kote, gjykata, prokuroria e shtetit dhe policia detyrohen

qe me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe përkujdesje te njëjtë te vërtetojnë fakte kundër te pandehurit si dhe ato ne favor te atij.... Andaj prokurorja e shtetit është ne diskreciaonin e saj provën ku cekëte lista e kafshëve sipas fermave e dhënë ne emër te Rr.K te date 08.04.2022.Në fund kërkon që duke u mbështetur në dispozitën e nenit 364 par 1 nën par 3 të KPPK të mbrojturin e tij ta liroj nga aktakuza .

I akuzuari P.H në fjalën përfundimtare deklaron:- E mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe nuk kam se çfarë te shtoj.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes deklarinimin e dëshmitarit – të dëmtuarit rr.K dhe vëren se ka një vazhdimësi logjike është identike me deklaratat e dhëna më herët në polici dhe prokurori, plotësohet dhe vërtetohet deklaratat e dëshmitarit B.K po ashtu si dhe me provat materiale Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve te datës 17.01.2018, vërtetimi mbi kthimi e sendeve te sekuestruara i date 17.01.2018 dhe foto dokumentacioni ndërsa plotësohet edhe nga vet deklarimi i të pandehurve sa i përket vjedhjes së lopëve prej stallës së tij dhe se ai personalisht nuk e dinë se kush ia ka vjedh ato dhe deklarimit të tij gjykata i fali besimin.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes deklarimet e dëshmitarit B.K dhe se vëren se ka një vazhdimësi dhe lidhje logjike në mes veti i cili deklarim ka mbështetje në deklaratën e të dëmtuarit dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se deklarimeve të tilla gjykata ia fali besimin.

Gjykata shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes edhe provat materiale dhe atë Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm te sendeve te datës 17.01.2018, vërtetimi mbi kthimi e sendeve te sekuestruara i date 17.01.2018 dëshminë e veterinerit A.H i cili dëshmoi se matrikulat e gjetura në vendngjarje nuk i përkasin gjedheve të dëmtuarit dhe foto dokumentacioni, shqyrtimit dhe analizës që iu bë të njëjtëve Gjykata i fali besimin, ngase e njëjta është lëshuar nga organi kompetent dhe nuk është kundërshtuar nga palët.

Gjykata morri në shqyrtim mbrojtjen e të akuzuarve M.T dhe P.H të cili nuk e ka pranuar veprën penale duke e kundërshtuar se gjedhët i kishin vjedhë stallën e të dëmtuarit, mirëpo i akuzuari P. nuk e mohon faktin se kishte blerë një lopë në tregun e prej disa shitësve n dhe se të njëjtën i a kishte shitur pastaj të akuzuarit M. tek i cili është gjetur pastaj nga policia dhe është sekuestruar, Gjykata t nuk i fali besimin ngase atë nuk e argumentuan me asnjë provë të vetme dhe se nuk arriti ta vë në dyshim dëshminë e dëshmitarit – të dëmtuarit, dëshmitarit dhe provave materiale të prezantuara gjatë seancës gjyqësore ku u vërtetua se të njëjtit ishin n

dijeni se lopa e blerë në treg ishte e vjedhur ose produkt i kësaj vepre ngase nuk ka poseduar shenjë identifikuese por edhe faktin se të njëjtën ia kanë shitur tre persona .

Gjykata ka bërë vlerësimin e provave të shqyrtuara një nga një dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike: Me 17 Janar 2018, i akuzuari P.H në fshatin ... komuna e Vushtrrisë në tregun e kafshëve nga persona të panjohur kishte blerë një lopë nga tre persona që nuk i ka njohur në çmim prej 830 euro dhe të njëjtën me qëllim përftimi ia ka shitur blerësit M.T që e njihte edhe me herët në çmim prej 950 euro edhe pse të njëjtit ishin në dijeni se kafsha lopa në fjalë ishte e vjedhur, ngase ishte blerë nga shitës të pa identifikuar dhe pa matrikulla që posedojnë kafshët në këtë rast dhe se si rrjedhojë pas identifikimit që i është bërë nga ana e djalit të pronarit e njëjta i është kthyer të dëmtuarit Rr.K.

Kjo vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarit – të dëmtuarit Rr.K, deklaratat e dëshmitarit B.K dhe provat materiale Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 17.01.2018, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara i datë 17.01.2018 dhe foto dokumentacioni, por se njëhë rit kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e vet të akuzuarve.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprave penale blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 71, 72 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese nuk gjeti ndonjë rrethanë pos që të njëjtit nuk ishin të dënuar më parë, ndërsa rrethanë rënduese faktin vet veprimtaria e tyre është informale-paregjstruar , shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrethanave të kryerjes dhe dëmin e shkaktuar.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë dhe të autorëve të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventive gjenerale).

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par. 2, nën par. 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komform nenit 39 par. 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të theksuarës më lartë u vendos si në diapozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:163786, 03.06.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.